



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 51 regjistër (JR)
Datë 06.11.2023

Nr.14 i vendimit
Datë 09.02.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Ina Rama	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– shpalli në seancë gjyqësore publike, ditën e hënë, datë 09.02.2026, në orën 16:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 51/2023 (JR), që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florjan Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 701, datë 25.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni C, pika 2 dhe neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,(në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, z. Klodjan Braho, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 701, datë 25.09.2023 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit,

dëgjoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, të paraqitura prej saj dhe avokates Romina Zano, që përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të vëzhgueses ndërkombëtare Elka Ermenkova,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari (në vijim “subjekti i rivlerësimit/subjekti”), për shkak të pozicionit të saj si ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë¹, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”), Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), nga Shkolla e Magjistraturës dhe vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

2.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*(ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;* (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;* (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë;* (iv) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, nëpërmjet verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të përcaktohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Në përfundim të procesit verifikues, AKSIK-ja ka dërguar raportin e hartuar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

2.3. KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dhe duke përzgjedhur 5 (pesë) dokumente të tjera ligjore, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për të.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, pasi administroi prapësimet e subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ, të kryer për kriteret e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe pasi zhvilloi seancën dëgjimore më datë 18.07.2022, bazuar në

¹ *Subjekti i rivlerësimit është emëruar në pozicionin ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me Urdhrin nr. {***} prot., datë 14.04.2016, të kryetarit të kësaj gjykate.*

nenin E, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, nenin 44, shkronja “b”, si dhe nenin 60, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm nr. 5 (nr. 496 akti), datë 20.07.2022, në lidhje me kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ka vendosur: (1) *Pezullimin nga detyra të znj. Jurida Bajraktari, për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit për ndihmës ligjor, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.* (2) *Në përfundim të këtij trajnimi, pas administrimit të rezultateve të arritura nga subjekti, Komisioni do të përfundojë procesin e rivlerësimit, bazuar mbi të tria kriteret. [...].* (4) *Ky vendim është i paankimueshëm, bazuar në pikën 2, të nenit F të Aneksit të Kushtetutës.*

4. Në këtë vendim të ndërmjetëm të Komisionit, janë referuar gjetjet e raportit të KLGj-së, shpjegimet, prapësimet dhe provat e paraqitura prej subjektit gjatë hetimit administrativ kryesisht, gjetjet në raportin e hetimit administrativ sa i përket kriterit të aftësive profesionale, si dhe rezultatet e testimit të aftësive profesionale *ex officio* përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, si një prej kriterëve të vlerësimit². Në konkluzionin përfundimtar, mbi të cilin mbështetet vendimi i ndërmjetëm, Komisioni ka konstatuar se në drejtim të kriterit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit gjendet “*me mangësi*”, duke vlerësuar, ndër të tjera, se: “*Subjekti i rivlerësimit nuk tregon aftësi profesionale si aftësia për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parime të përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën. Një kriter i vlerësuar me mangësi është edhe angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion dhe aftësia profesionale dhe angazhimi profesional. Lidhur me përvojën profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe emërimin në detyrën e ndihmësit ligjor, trupi gjykues çmon se arsyetimi dhe gjykimi që subjekti i ka bërë kriterëve, si dhe vlerësimi në lidhje me jetëshkrimin profesional, reflekton mangësi. Subjekti ka aplikuar për një pozicion pune që duket se nuk përputhet me përvojën e saj dhe këtë fakt ajo nuk ka qenë në gjendje ta arsyetojë. Trupi gjykues e konsideron këtë fakt në këtë mënyrë, pa dashur të ndërhyjë në gjykimin e komitetit ad hoc [...]. Një jurist i aftë duhet të jetë në gjendje të vlerësojë faktin nëse përmbush apo jo kriteret formale të shpallura dhe të arsyetojë bindshëm si e ka gjetur vetën brenda tyre[...]. Trupi gjykues i Komisionit, duke çmuar në tërësi problematikat e konstatuara, vlerëson se janë të tilla që të mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit për ndihmës ligjor pranë Shkollës së Magjistraturës”.*
5. Në përfundim të programit të trajnimit, Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.07.2023, përcolli në Komision rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, vlerësuar me nivelin “Mirë”, duke arritur në përfundimin se ka kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e ndërmjetëm të Komisionit.
6. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, me detyrë ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur: (a) një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (b) një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; dhe (c) një nivel të kënaqshëm kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale pas përfundimit me sukses të trajnimit, bazuar

² *Nga informacioni i përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. {***} prot., datë 23.05.2018, ka rezultuar se sipas rezultateve të testimit pranë Shkollës së Magjistraturës, për subjektet e rivlerësimit ex officio, zhvilluar në datat 7-8 maj 2018, të miratuara me vendimin e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, subjekti ka fituar në fazën e parë 44 pikë nga 100 në total, dhe në fazën e dytë 132 pikë nga 200 në total.*

në nenin 58, pika 1, shkronja “a” dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 701, datë 25.09.2023, ka vendosur konfirmimin e saj në detyrë.

6.1. Komisioni e mbështeti vendimin e mësipërm në arsyetimin e përmbledhur si vijon.

Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: [...] Pavarësisht disa gjetjeve lidhur me mosdeklarime apo pasaktësi në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, nuk ka rrethana të tilla që mund të cenojnë kriterin e vlerësimit të pasurisë apo procesin në tërësi të rivlerësimit të subjektit. Në konkluzionin përfundimtar, trupi gjykues është bazuar në aplikimin e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë rrethanat e konstatuara të lidhura me pasuri të krijuara para detyrë, në mungesë të kontributit financiar nga subjekti, si dhe në mosevidentimin e ndonjë rrethane tjetër për deklaratim të rremë, fshehje pasurie apo që të ardhurat të jenë rrjedhojë e ndonjë veprimtarie të kundërligjshme, që mund të cenonte pozitën e saj në këtë proces. Për sa u arsyetua më sipër, konsideruar gjithashtu funksionin e saj si ndihmëse ligjore dhe periudhën e ushtrimit të kësaj detyrë prej saj gjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar dhe në nivelin e rrethanave specifike të rezultuara për këtë subjekt, vlerësohen nga trupi gjykues se nuk cenojnë qëllimin e ligjit që normon procesin e rivlerësimit kalimtar. Ky konkluzion i trupit gjykues është në koherencë edhe me vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) *S vs Albania*, paragrafin 96. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, ka arritur nivel të besueshëm, sipas parashikimit të shkronjës “a, të nenit 59/1 të ligjit 84/2016. [...].

Për kriterin e kontrollit të figurës: [...] subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016. [...].

Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...] Bazuar në rezultatet e arritura, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik, si dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 31, datë 18.07.2023, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, është vlerësuar “mirë” në testimin përfundimtar, duke tejkaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Për sa rezultoi më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel kualifikues në vlerësim të aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të nenit 59/1 të ligjit 84/2016. [...].

III. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik dhe procedura e shqyrtimit

7. Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim, Komisioneri Publik) ka ushtruar ankim kundër vendimit objekt shqyrtimi, pasi ka çmuar se ai përmban shkaqe ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) dhe ka pretenduar se nga vlerësimin tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit duhet të gjejë zbatim neni 61, pika 5 e këtij ligji. Bazuar në nenet Ç, D, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, nenin 61, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ka kërkuar që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 701, datë 25.09.2023, të Komisionit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari. Në mënyrë të përmbledhur, Komisioneri Publik sjell në pah si vijon.

7.1. Lidhur me aspekte të zbatimit të ligjit dhe ato procedurale të vendimit. Në vlerësim të Komisionerit Publik, në çështjen objekt shqyrtimi, shtrohen paraprakisht çështje të zbatimit të

ligjit si vijon: (i) në analizë të akteve në dosje, rezultateve të hetimit administrativ, prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese³ dhe në jurisprudencën e Kolegjit, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe çmon se në vlerësimin tërësor të procedurave, të lidhura me kontrollin e aftësisë profesionale dhe pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke u gjendur, po ashtu, në kushtet që mangësitë e evidentuara lidhur me aftësitë profesionale janë të tilla që nuk mund të plotësohen, as nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, përkundër sa ka disponuar me vendim të ndërmjetëm Komisioni; (ii) lidhur me shkakun ligjor të “*cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë*”, jurisprudenca e Kolegjit ka vendosur standardin se është plotësisht e përshtatshme që institucionet e rivlerësimit të japin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi vetë ligji nr. 84/2016, në nenin 61, pika 5 e tij, autorizon në mënyrë specifike një masë të tillë disiplinore, në rastet kur subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe objektive tërësinë e sjelljeve të subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtjen e interesit publik në këtë proces; (iii) për sa i përket matjes së cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, jurisprudenca e Kolegjit ka vendosur standardin që institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të gjenerojnë besim të vazhdueshëm të publiku, duke vepruar në mënyrë efektive dhe të drejtë, në përputhje me legjislacionin dhe duke e demonstruar këtë të qytetarët. Ka një sërë sjelljesh nëpërmjet të cilave subjektet e rivlerësimit minojnë integritetin e institucioneve të drejtësisë dhe cenojnë besimin e publikut në sistemin tonë të drejtësisë, përmes korrupsionit, marrëdhënieve të rreme, shkeljes së betimit si nëpunës publik, veprimet në situatën e konfliktit të interesit, pa aftësisë në punën profesionale, vendosjes së interesave privatë përpara interesit publik etj.

7.2. Problematikat e evidentuara në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, që paraqiten prej Komisionerit para juridiksionit kontrollues të Kolegjit lidhen me: (i) sjellje të shfaqura në deklarin në funksion të kontrollit të pasurisë; (ii) mangësi të evidentuara nga organi përkatës ndihmës i vlerësimit të aftësive profesionale (KLGj); (iii) sjellje të dala nga aktet e administruara nga Komisioni, për procedurën e emërimit në detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit.

7.2.1. Gjetje në kontrollin pasuror. Gjatë hetimit administrativ rezultuan akte që dëshmojnë marrëdhënie financiare të padeklaruara në deklaratën *vetting*, konkretisht për: (i) qenien palë në kontratën *për kreditim me kusht dhe hipotekimi*, me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 15.12.2016, me palë kreditore Procredit Bank ShA dhe palë debitore znj. Sh. H. person fizik, palë debitor/hipotekues z. G. H. dhe palë debitore/solidar z. R. H. personi i lidhur (bashkëshorti), kredia është në shumën 35.000.000 lekë; (ii) kontratë kredie me të njëjtat palë me nr. {***}, datë 27.12.2016, bashkëlidhur së cilës në Aneksin nr. 2, shuma 2.600.000 lekë ka si destinacion blerje shtëpie; (iii) kontratë kredie me të njëjtat palë me nr. {***}, datë 27.12.2016, bashkëlidhur së cilës, në Aneksin nr. 2, shuma 1.970.000 lekë ka si destinacion aktive fikse të përziera⁴; (iv) detyrimin nga kontrata e qirasë me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 23.09.2016, me palë qiradhënëse R. A. dhe palë qiramarrëse personin e lidhur, z. R.

³ *Vendimi i Gjykatës Kushtetuese 2/2017, paragrafi 54: “[...] Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias) [...]”.*

⁴ *Sipas akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, detyrimet ndaj Procredit Bank janë mbyllur nëpërmjet kontratës së kredisë me Bankën OTP Albania ShA, me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 26.8.2021, për shumën 60.000.000 lekë.*

H., me objekt pasuri 57m² sipërfaqe e brendshme, me lulishte, me vendndodhje në Tiranë, me afat 2-vjeçar dhe qira mujore 900 euro. Komisioni, me aktin “Rezultatet e hetimit”, ka pasqyruar rrethanat e verifikuara sa më sipër, në formën e konstatimeve, ndërkohë që në datën 14.07.2022, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet e saj për kredinë, si dhe për kontratën e qirasë, duke paraqitur deklarata noteriale të znj. Sh. H., në cilësinë e kredimarrësit dhe z. R. A., në cilësinë e palës qiradhënëse, duke mosparashtruar shkaqe të tilla ligjore që të sillnin si pasojë shuarjen e detyrimit të deklarimit në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, duke u gjendur kështu subjekti i rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pasaktë. Në rastin konkret, këto rrethana të konstatuara nga Komisioni, për shkak të nevojës së vlerësimit në harmoni me gjetjet dhe përfundimet e tjera në ankim, duhen mbajtur në konsideratë për vlerësimin tërësor të procedurës së rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

7.2.2. Gjetje në vlerësimin profesional. Nisur nga konstatimet në raportin vlerësues të KLGj-së⁵, që janë pjesë e rezultateve të hetimit të Komisionit, parashtrohet se lidhur me: (i) treguesin e *aftësisë profesionale*, vlerësuar sipas nëntreguesve *njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor*, nuk mund të konfirmohet në 5 dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short; (ii) treguesin *aftësitë organizative*, vlerësuar sipas nëntreguesve *aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*, rendimenti nuk mund të përcaktohet, pasi kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale, *aftësia për të kryer procedurat gjyqësore* nuk mund të nxirret nga 5 dosjet e vëzhguara; (iii) treguesin *aftësia për të administruar dosjet*, nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore nuk kanë datë përpilimi dhe janë nënshkruar vetëm në fund nga ndihmësi ligjor me rekuizitën “konceptoi”; (iv) treguesin *etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale*, vlerësuar sipas nëntreguesve *etika në punë* referohet eksperiencia si juriste në shoqërinë “{***}” ShPK, dhe se nuk disponohen të dhëna nga burimet arkivore; për treguesin *integriteti* nuk konstatohen të dhëna dhe për treguesin *paanësia* nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, ndërsa në 5 dosjet e përzgjedhura nuk rezultojnë të administruara akte procedurale të hartuara nga subjekti i rivlerësimit; (v) treguesin *aftësia profesionale dhe angazhimi profesional* vlerësuar sipas nëntreguesve *aftësia e komunikimit* nuk ka të dhëna për t’u vlerësuar, *aftësia për të bashkëpunuar* nuk janë konstatuar të dhëna specifike, *gatishmëria për t’u angazhuar* rezultojnë pjesëmarrje në trajnime në Shkollën e Magjistraturës.

7.2.3. Lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, konstatimi i Komisionit rezulton të ketë mbetur i pandryshuar dhe në përputhje me sa KLGj-ja kishte konstatuar në aktin e hartuar në përputhje me ligjin, edhe pas depozitimit nga subjekti të disa dokumenteve të tjera ligjore të përgatitura prej saj gjatë ushtrimit të detyrës, sipas kërkesës kryesisht të Komisionit. Në këto rrethana, Komisioni, me vendimin e ndërmjetëm nr. 5, nr. 496 akti, duke arsyetuar se [...] *dukshëm subjekti nuk ka reflektuar qartësi në arsyetim, madje në shumë raste ai mungon tërësisht, çka krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit, në pozicionin e ndihmësit ligjor nuk arrit nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale si në aspektin e njohurive të saj ligjore apo aftësive profesionale. Në materialet e përgatitura prej saj nuk janë identifikuar tregues të tillë si, aftësia për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, apo aftësia për të interpretuar jurisprudencën [...], si dhe [...] ka mangësi në arsyetimin ligjor dhe në aftësinë për të përgatitur opinione të karakterit procedural apo edhe material për çështjet në gjykim. Evidentohen mangësi në rolin e saj si ndihmëse ligjore dhe në*

⁵ “Për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, për periudhën 14.04.2016-14.04.2019”.

aftësinë për të përmbushur detyrat sipas përcaktimeve ligjore për pozicionin e ndihmësit ligjor [...], [...] eksperiencia e punës e znj. Bajraktari nuk ka qenë në harmoni me kërkesat ligjore që kërkojnë përvojë profesionale si jurist në organet e sistemit të drejtësisë; funksione publike në administratën e Kuvendit; administratën e Institucionit të Presidentit; aparatit e Këshillit të Ministrave; ministri dhe institucione qendrore të pavarura; Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, prokurorinë, si avokat apo personel akademik i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës [...], ndërsa në përfundim, [...] duke çmuar në tërësi problematikat e konstatuara, vlerëson se ato janë të tilla që mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës [...]. Në vendimin përfundimtar, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e arritura në testimin përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës, ku është vlerësuar “mirë”, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

7.2.4. Nga aktet e administruara në dosjen e Komisionit, Komisioneri Publik vjen në përfundimin se veprimtaria profesionale e subjektit të rivlerësimit është, sikundër organi përkatës i vlerësimit të aftësive profesionale ka konstatuar, pasqyrë e mungesës së evidentimit të treguesve të matshëm të aftësive profesionale në një sasi të konsiderueshme, çka përfaqëson një model pune të dobët, i cili nuk pajtohet me pozicionin e saj, dhe se në vlerësim të mangësive të vërejtura, për shkak të vijueshmërisë dhe rëndësisë së tyre, nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të edukimit.

7.2.5. *Gjetje në procedurën e punësimit.* Në referencë të shqyrtimit të kriterit të aftësive profesionale, Komisioni me të drejtë është ndalur dhe ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, referuar të dhënave të regjistrave zyrtarë përkatës, në momentin e aplikimit nuk përmbushte kriteret e përcaktuara në nenin 6/3 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për sa eksperiencia e punës lidhej më së shumti me punësimin në entitete private (shoqëri tregtare, shoqata sportive, etj.), por edhe se në tërësi përvoja e punës së dokumentuar ishte rreth 3 vite e gjysmë, përkundrajt përvojës prej 7 vite të kërkuar nga ligji.

7.2.6. Komisioni, edhe pse në vendimin e ndërmjetëm edhe në atë përfundimtar, këtë procedurë emërimi e ka gjetur në : *[...] mospërmbushje në mënyrë kumulative të kriterit ligjor, e ka çmuar mangësi si pjesë e mungesës së duhur të formimit profesional dhe aftësive të saj për të identifikuar konfliktin e normave po aftësinë për të analizuar jurisprudencën për të për të përgatitur opinione të karakterit procedural apo dhe material për çështjet në gjykim[...], e ka konsideruar të tillë që mund të plotësohet nëpërmjet programit të trajnimit për Ndihmës Ligjor në Shkollën e Magjistraturës.*

7.2.7. Komisioneri Publik vlerëson se mospërmbushja e kriterit ligjor në procedurën e punësimit nuk mund të konsiderohet si e riparueshme nëpërmjet programit të trajnimit dhe se kjo situatë e gjen subjektin e rivlerësimit me sjellje jo të përshtatshme, përkundrajt sa kërkohet nga funksionari i sistemit të drejtësisë, në kushtet kur ka pranuar të ushtrojë një funksion brenda sistemit të drejtësisë, për të cilin nuk përmbushte dukshëm kriteret specifike të parashikuara nga ligji, qoftë lidhur me natyrën e përvojës profesionale të punës, qoftë me kohëzgjatjen në vite të kësaj përvoje profesionale, duke cenuar në këtë mënyrë etikën profesionale.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

ii) Legjitimimi i ankuesit

9. Komisioneri Publik legjitimohet (*ratione personae*), në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe (*ratione temporis*), pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

10. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 701, datë 25.09.2023, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.
11. Në seancën gjyqësore publike të datës 20.01.2026, në zbatim të përcaktimeve të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vendosi kalimin procedural të ankuesit nga Komisioneri Publik Florian Ballhysa, te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho.
12. Në parashtrimet e tij lidhur me ankimin, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme deklaroi se u qëndron shkaqeve të ankimit të ushtruar nga Komisioneri Publik kundër vendimit objekt shqyrtimi, pasi, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, ndan qëndrim të ndryshëm nga vlerësimi i Komisionit, që, pas konstatimit të mangësive profesionale nga ana e subjektit të rivlerësimit, pati vendosur pezullimin e saj nga detyra dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme deklaroi se nga analiza e akteve në dosje rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të arrijë qoftë dhe nivelin minimal të kualifikimit për këtë kriter dhe se është evidentuar edhe deklarim i pasaktë i pasurisë prej saj. Për pasojë, problematikat shfaqen të tilla që nuk mund të korrigjoheshin nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës dhe subjekti i rivlerësimit duhet të konsiderohet e papërshtatshme për të vijuar detyrën, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe ndaj saj duhej aplikuar masa e shkarkimit nga detyra.
13. Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e paraqitura përpara çeljes së seancës gjyqësore publike⁶, si dhe gjatë gjykimit në Kolegj, përmes përfaqësueses së saj ligjore, avokate Romina

⁶ Administruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 08.01.2026.

Zano, u shpreh se ankimin e Komisionerit Publik e vlerëson si të ushtruar në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit, me parimet themelore kushtetuese, me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të pabazuar në ligj edhe në prova. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti prapësoi si vijon.

Lidhur me gjetjet për kontrollin e pasurisë

13.1. Në kontratën për kreditim me kusht dhe hipotekim të datës 14.12.2016, kredimarrëse ka qenë shtetasja Sh. H., nëna e bashkëshortit, e cila ka marrë kredinë për qëllime biznesi, në cilësinë e personit fizik tregtar. Në këtë kontratë bashkëshorti R. H. ka firmosur në cilësinë e debitorit solidar, jo në cilësinë e kredimarrësit apo hipotekuesit, si pasojë e politikave standarde të bankave të nivelit të dytë, sipas së cilave, në rastet kur kredimarrësi kryesor kalon moshën 65 vjeç gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë kërkohet nënshkrimi i një personi nën këtë moshë si garantues i detyrimit. Për rrjedhojë, bashkëshorti nuk ka administruar shumën e kredisë, nuk ka përfituar ekonomikisht nga kjo marrëdhënie kontraktore, ky detyrim nuk përbën pasuri dhe as detyrim financiar personal të tij në kuptimin substancial të ligjit nr. 84/2016, nuk krijon detyrim për deklaram në deklaratën *vetting*, për sa kohë nuk ka ndikuar në gjendjen pasurore të tij apo të familjes së saj dhe nuk ka asnjë lidhje me ushtrimin e funksionit të saj publik. Komisioneri Publik nuk ka paraqitur asnjë provë që ky detyrim të ketë sjellë përfitime për bashkëshortin apo të ketë qenë i lidhur me aktivitetin e tij personal, dhe trajtimi i kësaj marrëdhënie juridike përbën një interpretim formal dhe të zgjeruar përtej qëllimit të ligjit nr. 84/2016, duke u shkëputur nga parimi i proporcionalitetit dhe nga kriteri thelbësor i cenimit të besueshmërisë, i parashikuar në nenin 30 të ligjit. Për rrjedhojë, ankimi i Komisionerit Publik lidhur me këtë shkak është i pabazuar në ligj dhe në fakte dhe duhet të rrëzohet nga Kolegji, pretendoi subjekti.

13.2. Në lidhje me kontratën e qirasë të datës 23.09.2016, nga hetimi administrativ, ka rezultuar se është lidhur formalisht prej bashkëshortit, me qëllimin paraprak për ushtrimin e një aktiviteti tregtar, por që nuk është ekzekutuar asnjëherë nga palët, të cilat e kanë revokuar këtë marrëveshje brenda një periudhe shumë të shkurtër kohe, duke u kthyer në gjendjen e mëparshme, nuk është paguar asnjë këst qiraje, objekti nuk është përdorur dhe nuk ka lindur asnjë detyrim financiar për asnjërën palë. Në këto kushte, mosdeklarimi i kësaj kontrate në deklaratën *vetting* nuk përbën shkelje të ligjit nr. 84/2016, nuk përmbush standardin e “deklarimit të pasaktë”, në kuptim të nenit 30 të ligjit, për rrjedhojë edhe ky shkak ankimor duhet të rrëzohet nga Kolegji.

Lidhur me gjetjet në vlerësimin profesional

13.3. Pretendimi i Komisionerit Publik se mangësitë e konstatuara “nuk mund të korrigjohen” përmes programit të trajnimit bie ndesh drejtpërdrejt me ligjin nr. 84/2016, i cili parashikon shprehimisht trajnimin si instrument korrigjues dhe ia njeh Shkollës së Magjistraturës autoritetin ekskluziv për të vlerësuar rezultatet e tij. Pretendimet e Komisionerit Publik se veprimtaria profesionale e subjektit përfaqëson një “model pune të dobët” dhe se mangësitë janë të tilla që nuk mund të korrigjohen, nuk mbështeten në prova të reja apo në shkelje konkrete të ligjit nr. 84/2016, por kufizohen në përsëritjen e gjetjeve paraprake, të cilat Komisioni i ka konsideruar të tejkaluara përmes mekanizmit të trajnimit, pa identifikuar elementë faktikë apo juridikë që të vënë në diskutim vlefshmërinë e vlerësimit përfundimtar të

Shkollës së Magjistraturës. Sipas subjektit kjo qasje do të zhvlerësonte rolin dhe autoritetin e Shkollës së Magjistraturës si institucion akademik dhe profesional i specializuar, si dhe do të cenonte parimin e sigurisë juridike, duke e shndërruar procesin e rivlerësimit në një mekanizëm të pafund rishqyrtimi të gjetjeve tashmë të korrigjuara.

13.4. Subjekti pretendoi se nga pikëpamja formale dhe përmbajtësore, relacionet dhe materialet e përgatitura prej saj janë hartuar në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 6, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 dhe reflektojnë ushtrimin korrekt dhe profesional të funksionit të ndihmësit ligjor, në kushtet e një ngarkese të lartë pune dhe në përputhje me kërkesat konkrete të gjyqtarëve pranë të cilëve ka ushtruar detyrën, sipas modeleve dhe metodikës së punës së përcaktuar prej tyre. Sipas saj, ka kryer kërkime të vazhdueshme mbi problematika të karakterit procedural dhe material, duke identifikuar dhe analizuar dispozitat përkatëse ligjore, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese, si dhe burime të tjera relevante, në përputhje me detyrat e dhëna, shpeshherë edhe verbalisht, si dhe ka përgatitur projektvendime në tërësi, përjashtuar pjesën e arsyetimit përfundimtar, e cila, për nga natyra e funksionit dhe përgjegjësisë kushtetuese, i përket ekskluzivisht gjyqtarit. Duke potencuar se gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës nuk ka pasur asnjë masë disiplinore, që dëshmon se nuk ka pasur shkelje të rregullave të brendshme, të ligjit apo të etikës profesionale prej saj, subjekti pretendoi se fokusi i vlerësimit duhet të qëndrojë tek aftësia për të ushtruar funksionin ndihmës në mënyrë efektive, dhe se pretendimi i Komisionerit Publik për mungesë treguesish të matshëm apo për nivel të pamjaftueshëm profesional mbetet i pabazuar, si në ligj, ashtu edhe në aktet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit.

Lidhur me gjetjet për procedurën e punësimit

13.5. Subjekti kundërshtoi shkakun e ankimit *se mospërmbushja e kriterit ligjor në procedurën e punësimit nuk mund të konsiderohet si e riparueshme përmes programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës dhe se kjo situatë përbën sjellje jo të përshtatshme dhe cenim të etikës profesionale, në kushtet kur subjekti ka pranuar të ushtrojë një funksion në sistemin e drejtësisë, pa përmbushur kriteret specifike ligjore për përvojën profesionale, si të pabazuar në ligj, në prova dhe në parimet që udhëheqin procesin e rivlerësimit kalimtar.* Sipas saj: (i) dispozitat e ligjit nr. 8136/1996, neni 2 që përcakton se Shkolla e Magjistraturës ka për qëllim sigurimin e formimit profesional të magjistratëve dhe neni 3 që parashikon programin njëvjeçar të formimit fillestar, i cili përfshin përgatitjen teorike, praktike dhe etike, tregojnë qartë se ligjvënësi ka pranuar parimin se formimi profesional nuk është i kufizuar vetëm në përvojën paraprake, por konsolidohet dhe plotësohet përmes trajnimit të detyrueshëm; (ii) etika profesionale lidhet me integritetin personal, ndershmërinë, paanshmërinë, respektimin e ligjit dhe të detyrimeve funksionale, dhe jo me mënyrën se si administrata ka interpretuar ose zbatuar kriteret e përzgjedhjes në një procedurë punësimi, ku çdo mospërputhje e mundshme në interpretimin e përvojës profesionale, nëse do të ekzistonte, është përgjegjësi e administratës punësuese dhe jo e kandidatit, dhe se në rastin e saj nuk ka asnjë provë që të ketë fshehur të dhëna apo paraqitur deklarime të pavërteta për të përfutur pozicionin; (iii) aplikimi i parimit të sigurisë juridike dhe i besimit të ligjshëm përjashton mundësinë që një situatë e pranuar dhe e certifikuar nga vetë institucionet e sistemit të drejtësisë, pas shumë vitesh të ushtrimit të funksionit pa u kontestuar, pas ndjekjes dhe përfundimit me sukses të programit të Shkollës së Magjistraturës dhe vlerësimit pozitivisht për aftësitë profesionale, të cilësohet si sjellje jo e

përshtatshme apo cenim etik. Në këto kushte, pretendimi i Komisionerit Publik për *cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë* mbështetet në supozime dhe jo në fakte konkrete apo në dispozita ligjore të aplikueshme, për rrjedhojë duhet të rrëzohet si i pabazuar në ligj dhe në fakt.

14. Në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i qëndroi vlerësimin se mangësitë e subjektit të rivlerësimit, në aspektin profesional janë të tilla që nuk mund të korrigjoheshin nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës i ndjekur prej saj, dhe se nuk u arrit të provohej e kundërta e ankimit as lidhur me pasaktësitë e evidentuara në deklarin e pasurisë të paktën lidhur me mosdeklarimin e një kontrate kredie. Sa i përket mosdeklarimit prej subjektit dhe personit të lidhur, të kontratës së qirasë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u shpreh se vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur nuk evidentohet ndonjë e dhënë që kontrata të ketë prodhuar efekte financiare, që do të ndikonin në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të. Gjithashtu, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, lidhur me shkakun ankimor për procedurën e punësimit, duke theksuar edhe se pavarësisht se në dijeni të plotë se nuk i plotësonte kriteret ligjore të nevojshme, subjekti ka paraqitur kërkesën e datës 01.04.2016 ku përshkruhet se paraqet kërkesë për vendin e lirë të punës “Ndhmës Ligjor”, duke u nisur mes të tjerave edhe nga “[...] përvoja dhe përgatitja ime profesionale, si dhe kriteret e vendosura”, e se në këtë mënyrë ka fshehur fakte të vërteta, veprim i cili, pa lënë mënjanë edhe veprimet e funksionarëve të drejtësisë që kanë kryer emërimin e saj, ka të bëjë si me papërshtatshmërinë e saj me funksionin, por edhe me etikën e magjistratëve dhe ndihmësve ligjorë, që duhet të kenë në raport me të drejtën dhe të vërtetën. Për sa më sipër, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kërkoi që Kolegji të marrë në konsideratë, në vlerësimin tërësor të çështjes, edhe fshehjen prej subjektit të rivlerësimit të fakteve të vërteta që tregonin mospërmbushjen e kriterëve ligjore nga ana e saj në procedurën e punësimit si ndihmëse ligjore, si cenim të etikës së saj profesionale, mangësi kjo e pakorrigjueshme nga programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës.
15. Në përfundim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme deklaroi se subjekti i rivlerësimit konsiderohet e papërshtatshme për të vijuar detyrën, pasi ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe gjendet në kushtet e zbatimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke kërkuar përfundimisht ndryshimin e vendimit të Komisionit e shkarkimin e saj nga detyra.
16. Përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit dha shpjegime të detajuara për shkaqet e ankimit, duke prapësuar se ato janë të padrejta e të pabazuara në ligj e në prova. Lidhur me kriterin e vlerësimit profesional, përfaqësuesja ligjore deklaroi se pretendimet për mungesë të aftësive profesionale nuk gjejnë mbështetje faktike dhe ligjore, pasi standardi i vlerësimit duhet të jetë proporcional me rolin e ndihmësit ligjor, dhe se i vetmi autoritet që vlerëson korrigjimin e mangësive të subjektit të rivlerësimit në aspektin profesional pas ndjekjes së trajnimit është Shkolla e Magjistraturës, e cila ka dhënë vlerësim pozitiv, çka duhet konsideruar si provë vendimtare në këtë proces. Përfaqësuesja ligjore deklaroi se procedura e punësimit si ndihmëse ligjore e subjektit të rivlerësimit nuk duhej përfshirë si shkak ankimi, ndërsa përsëriti qëndrimin se pasaktësitë në deklarin e pasurisë nuk janë të tilla që të përmbushin standardet e deklarinimit të pasaktë. Duke vlerësuar se nuk ka lidhje logjike në të tri kriteret e vlerësimit për cenim të besimit të publikut te drejtësia, sjellje apo prova konkrete, përfaqësuesja ligjore i kërkoi përfundimisht Kolegjit mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit.

17. Trupi gjykues, pasi analizoi pretendimet e ngritura nga Komisioneri Publik, në ankim, dhe ato të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në parashtrime dhe konkluzione përfundimtare, prapësimet e subjektit të rivlerësimit në gjykim dhe në konkluzione përfundimtare, si dhe pasi shqyrtoi provat shkresore të administruara në dosjen gjyqësore nën dritën e kuadrit ligjor të zbatueshëm, arriti në përfundimet e mëposhtme.

Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

18. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën *vetting* prej personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, të “Kontratës për Kreditim me Kusht dhe Hipotekim”, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.12.2016, trupi gjykues në konsideratë të rrethanave të faktit dhe ligjit të zbatueshëm konstaton dhe vlerëson si vijon.

18.1. *Së pari*, nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se: (i) Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit Noterial, ka dërguar të dhëna lidhur me veprime noteriale të kryera nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit shtetasi R. H., nga ka rezultuar se ai ka firmosur një kontratë kreditimi hipotekimi më datë 14.12.2016, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., pranë noteres I. I. T.. Kjo notere ka vënë në dispozicion aktin sipërcituar, me palë kreditor Procredit Bank ShA, debitor Sh. H., Person Fizik, debitor/hipotekues znj. Sh. H. dhe z. G. H. dhe debitor/solidar z. R. H.. Në kontratë parashikohet se: *Kreditori dhe Sh. H. PF, Sh. H. dhe G. H. (më poshtë të quajtur “debitori”) janë dakord që kreditori të kreditojë debitorin me kredi standarde, paradhënie bankare, linjë kredie, garanci bankare ose letra krediti deri në shumën 35.000.000 lekë sipas kërkesës së debitorit me kushtin që debitori të ketë përmbushur më parë kushtet e përcaktuara në kontratë*⁷. Dy kredite e tjera, të përmendura në ankim, të datës 27.12.2016, konkretisht, me numër {***} “Kontratë kredie kredi biznesi” dhe me numër {***} “Kontratë kredie rinovim, blerje, eficientë energjie”, janë lidhur në vijim të kontratës për kreditim me kusht dhe hipotekimit me nr. {***}/ {***}, datë 15.12.2016, mes të njëjtave palë dhe brenda shumës limit prej 35.000.000 lekë, ku bashkëshorti i subjektit R. H., figuron në cilësinë *debitor solidar*. (ii) Ndër dokumentet bankare të përcjellë nga Procredit Bank ShA, në njërin prej tyre “Aprovim” 8, nën titullin “dalje nga procedura”, është selektuar *mosha e kredimarrësit/bashkëpërgjegjësve [kredimarrësia dhe bashkëshorti kalojnë moshën 65 vjeç në maturim (Sh. 68 vjeç, G. 69 vjeç) ndaj është marrë edhe djali si debitor solitar]*. (iii) ILDKPKI-ja, lidhur me informacionin e përcjellë nga ProCredit Bank⁹, ka kërkuar sqarim për rolin e R. H. në kredi të marra nga personi fizik “{***}” dhe nëse ka vendosur garanci të tij. Në përgjigje, është dërguar sqarimi [...] R. H. është në rolin e debitorit solidar (garantor). *Arsyeja është se kredimarrësit (prindërit e tij) me maturimin e kredisë do të arrijnë një moshë mbi 65 vjeç dhe z. R. është marrë si debitor solidar (garantor) pasi parashikohet të jetë edhe trashëgimtar i*

⁷ Personi fizik “{***}” është kredituar me limit kredie 35.000.000 lekë, e cila është siguruar me pasuri të paluajtshme në pronësi të shtetasve G. dhe Sh. H. si vijon: arë 2.700 m² regjistruar në datën 08.06.2015, në Radë, Durrës, apartament 74 m² regjistruar në datën 16.09.2013, ndodhur në Kryemëdhenj, Kavajë, apartament me sipërfaqe 27,3 m² regjistruar në datën 16.09.2013, ndodhur në Kryemëdhenj, Kavajë, apartament me sipërfaqe 59,86 m² regjistruar në datën 30.12.2005, në Kryemëdhenj, Kavajë dhe apartament me sipërfaqe 126 m² regjistruar në datën 22.04.2015 në rrugën “{***}”, Tiranë. Lidhur me këto pasuri, konstatohet se janë përdorur si kolateral edhe për kredite të tjera të marra nga shtetasi G. H. në Credins Bank dhe BKT, duke filluar prej vitit 2006 e në vijim.

⁸ Formulari i datës 12.12.2016 është i nënshkruar nga nëpunës të bankës.

⁹ Administruar prej ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 07.07.2017, lidhur me kredite me status aktiv të personit fizik “{***}”, me nr. {***}, shuma 1.970.000 lekë disbursuar në datën 27.12.2016; me nr. {***} shuma 2.600.000 lekë disbursuar në datën 27.12.2016; me nr. {***} shuma 23.800.000 lekë disbursuar në datën 27.12.2016; me nr. {***} shuma 7.000.000 lekë disbursuar në datën 15.06.2017

*biznesit. [...] (iv) Në prapësime për rezultatet e hetimit administrativ¹⁰, subjekti shpjegon se: “Në deklaratën vetting nuk është deklaruar nga bashkëshorti im se ka nënshkruar në cilësinë e debitorit solidar, pasi është menduar nga ana e tij se në Deklaratën Vetting duhej të deklaroheshin kredi të marra nga ai si person fizik/juridik. Nga kontrata e kredisë midis ProCredit Bank dhe znj. Sh. H. (kredi që tashmë është blerë nga OTP Bank Albania, në rolin e kredidhënësit) është cilësuar se z. R. H. ka firmosur në cilësinë e debitorit solidar dhe jo në cilësinë e hipotekuesit. Përfshirja si dorëzanës është politikë e bankave të nivelit të dytë, ku në rast se kredimarrësi gjatë periudhës së shlyerjes së kredisë është mbi moshën 65 vjeç, duhet të ketë një person nën moshën 65 vjeç të nënshkruajë si debitor solidar, kusht i vendosur nga banka për marrjen e kredisë. Duke qenë se kredimarrësi Sh. H., nëna e bashkëshortit tim, gjatë kohëzgjatjes së shlyerjeve të kësteve të kredisë kalon moshën 65 vjeç, është vendosur kusht nga kredidhënësi që kjo kontratë kredie të firmoset si dorëzanës nga bashkëshorti im, duke bërë edhe policë sigurimi në emër të tij. Kjo kredi është marrë nga shtetasja Sh. H., nëna e bashkëshortit tim, me qëllim biznesi dhe si person tregtar (PF), si dhe duke qenë një kredi që nuk është marrë nga bashkëshorti im ose në funksion të tij, ai ka vlerësuar se nuk duhej ta deklaronte në Deklaratën Vetting”¹¹. Për sa shpjeguar, subjekti ka depozituar edhe deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.07.2022, të nënës së bashkëshortit Sh. H., e cila deklaron të njëjtat fakte, sikundër subjekti lidhur me kredinë bankare, dhe se kredia mbulohet nga të ardhurat e biznesit që administron “{***}” dhe se është e mbuluar 100% me hipotekë .*

18.2. Referuar kontratës së mësipërme, lidhur mes Pro Credit Bank, si kredidhënës dhe Personit Fizik Sh. H., si kredimarrës, prindërit e bashkëshortit të subjektit znj. Sh. H. dhe z. G. H., së bashku me atë vetë, kanë nënshkruar në këtë akt me cilësinë e debitorëve solidarë, ndërsa kredia, gjithashtu, rezulton e garantuar me vendosjen në hipotekë të disa pasurive të paluajtshme në pronësi të prindërve të bashkëshortit, të vlerësuar se mund të përballojnë shlyerjen e detyrimit të kredimarrësit ndaj bankës Nga dokumentacioni bankar i administruar në Komision rezulton se cilësia e debitorit solidar (garantor), prej bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit është fituar në zbatim të politikave të bankës, për shkak të arritjes së moshës mbi 65 vjeç të kredimarrësit me maturimin e kredisë. Gjithashtu, nuk konstatohet se bashkëshorti i subjektit të ketë përfituar ndonjë vlerë financiare nga shuma e kredisë së akorduar personit fizik apo të ketë shlyer ndonjë këst të kësaj kredie. Në këto rrethana, nuk rezulton që kjo marrëdhënie të ketë ndikuar në ndonjë mënyrë në pasuritë apo interesat privatë të subjektit e personit të lidhur.

18.3. Në kushtet e mësipërme, nga leximi harmonik i kuadrit ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues nuk konstaton ndonjë parashikim ligjor të qartë, që përcakton detyrimin e subjekteve të rivlerësimit apo personave të lidhur për të deklaruar në deklaratën vetting, marrëdhënie të kësaj natyre, të cilat nuk kanë prodhuar as të drejta pasurore dhe as detyrime financiare të drejtpërdrejta e korrente për ta. Në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016,

¹⁰ Lidhur me gjetjen “Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën vetting se ka nënshkruar në cilësinë e debitorit solidar në kreditë e biznesit të marra nga nëna e tij Sh. H.”

¹¹ Subjekti ka shpjeguar se bashkëlidhur parashtrimeve paraqet kopje të kontratës së kredisë të marrë nga nëna e bashkëshortit, znj. Sh. H. (PF) (me poshtëshënim subjekti referon kontratë kredie me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.08.2021, e cila ka përthithur kontratën e mëparshme të kredisë të vitit 2016) dhe shprehet [...] në të cilën është evidentuar pse duhet të firmosë një person nën moshën 65 vjeç për rastin në fjalë [...].

deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit, në formularin “Detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizikë”, sqarimet orientojnë për deklaram të detyrimeve të vetë subjekteve deklarues apo të vetë personave të lidhur, të cilët shfaqen në këto marrëdhënie drejtpërdrejt si kredimarrës. Gjithashtu, Udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, i ILDKPKI-së, dalë në bazë e për zbatim të ligjit nr. 84/2016, parashikon se *subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, deklarojnë të dhënat e detyrueshme për deklaram, pjesë përbërëse e këtij procesi deklarimi, me përshkrimet e kërkuara, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016*. Ndër rregullat e përcaktuara për mënyrën e plotësimit të deklaratës së pasurisë, si dhe dokumenteve që justifikojnë vërtetësinë e deklaramit dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, Udhëzimi i sipërcituar në pikën 24, parashikon *deklaramin e kredive të marra nga bankat/institucionet financiare, shoqëruar me kontratën e lidhur me bankën/institucionin financiar, kolateralin e vënë si garanci etj.*, duke fokusuar vëmendjen e deklaruesve në deklaramin e kredive, në të cilat ata vetë janë në cilësinë e kredimarrësve.

18.4. Në këto rrethana ligjore dhe faktike, trupi gjykues vlerëson se për shkak të: (i) paqartësisë së parashikimit ligjor drejt një detyrimi eksplicit të subjekteve për deklaramin e marrëdhënieve në të cilat ata nuk janë kredimarrës, por garantor; (ii) faktit se deklarata *vetting* është e para dhe e vetmja e plotësuar prej subjektit të rivlerësimit; (iii) marrëdhënia e kredisë nuk rezultojnë të ketë prodhuar asnjë pasojë konkrete në drejtim të pasurisë së subjektit; (iv) nuk evidentohen dyshime apo problematika, të cilat mund të ngarkojnë subjektin me përgjegjësi në drejtim të vlerësimit të pasurisë, e gjen të pabazuar pretendimin se me mosdeklaramin e kësaj marrëdhënieje në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

19. Në kushtet kur Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në konkluzionet përfundimtare, konsideroi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit bindëse, lidhur me mosdeklaramin prej personit të lidhur të një kontrate qiraje të lidhur prej tij me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.09.2016¹², trupi gjykues konstatoi se nuk rezultuan problematika të tjera lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, të cilat do të duhej/mund të vlerësoheshin në një vlerësim të përgjithshëm të tri kriterëve, duke konfirmuar qëndrimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm lidhur me këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

20. Lidhur me pretendimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme se mbetet e provuar që veprimtaria profesionale e subjektit të rivlerësimit, sikurse edhe organi përkatës i vlerësimit të aftësive profesionale ka konstatuar, është pasqyrë e mungesës së evidentimit të treguesve të matshëm të aftësive profesionale, në një sasi të konsiderueshme, çka përfaqëson një model pune të dobët, i cili nuk pajtohet me pozicionin e saj dhe, në vlerësim të mangësive të vërejtura, për shkak të vijueshmërisë dhe rëndësisë së tyre, ato nuk mund të korrigjohen përmes programit

¹² Në dosjen gjyqësore është administruar deklarata noteriale e shtetasit R. A. dhe bashkëshortit të subjektit, e depozituar prej subjektit me parashtrime, të cilët lidhur me kontratën e qirasë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.09.2016, deklarojnë se: [...] kontrata duke mos u ekzekutuar nga ne si palë, kemi rënë dakord me vullnetin tonë për të shuar kontratën e qirasë dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme; nuk është paguar asnjë këst i qirasë dhe objekti është dorëzuar tek qiradhënësi. Deklarojmë se nga ana jonë qiradhënësit R. A. dhe qiramarrësit R. H. është bërë dhe revokimi i kontratës së qirasë, kopje e të cilës nuk disponohet nga ana jonë. Ky revokim i kontratës së qirasë është kryer thjesht për të formalizuar mos vënien në ekzekutim të qirasë që në muajin që kjo kontratë është lidhur. [...].

njëvjeçar të edukimit, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson sa vijon.

20.1. Fillimisht trupi gjykues vlerëson të nënvizojë faktin se konfirmon të gjitha problematikat e konstatuara prej Komisionit lidhur me mangësitë profesionale të subjektit, si dhe mungesën e evidentave të njohurive dhe arsyetimit ligjor në dokumentet e marrë në analizë, sipas përcaktimeve të nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Ndërsa në funksion të shqyrtimit të pretendimit të ankuesit se këto mangësi kanë qenë të pashërueshme nga trajnimi njëvjeçar në Shkollën e Magjistraturës, trupi gjykues bëri një vlerësim të ndryshëm në konsideratë të të gjitha rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ.

20.2. Ndërsa konstatohen mangësi në drejtim të hartimit dhe përmbajtjes së akteve të përpiluara prej subjektit të rivlerësimit në cilësinë e ndihmësës ligjore, nuk evidentohen rregulla të qarta, të normuara nga ligji apo akte nënligjore që të përcaktonin qartësisht metodologjinë dhe elementët e detyrueshëm të akteve/relacioneve apo opinioneve të dhëna nga ndihmësja ligjore qoftë në drejtimin formal por edhe atë përmbajtësor.

20.3. Nga aktet në dosjen gjyqësore, rezulton se Gjykata Administrative e Apelit Tiranë¹³ ka informuar Komisionin se nuk ka pasur ndonjë rregullim të posaçëm lidhur me veprimtarinë e ndihmësave ligjorë, por ajo ka funksionuar në bazë të ligjit nr. 49/2012 dhe më pas të ligjit nr. 98/2016. Ndërsa, Ministria e Drejtësisë¹⁴ i është përgjigjur Komisionit se ka pasur në kompetencë inspektive dhe procedime disiplinore vetëm ndaj subjekteve që gëzojnë statusin e magjistratit dhe jo për subjekte të tjera të rivlerësimit si ndihmës ligjorë dhe, në këto kushte, nuk disponon ankesa nga palë të treta për shkak të detyrës apo vlerësime për masa disiplinore, duke mos evidentuar ndonjë të dhënë që ndihmon në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit.

20.4. Referuar parashikimeve të ligjeve sipërcituar¹⁵, ndihmësit ligjorë, si pozicione pune në mbështetje të veprimtarisë gjyqësore, ndihmojnë për përgatitjen e çështjes për gjykim, sipas udhëzimeve dhe kërkesave të gjyqtarit në bazë të të cilave bëjnë kërkime dhe përgatisin opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material. Në mungesë të akteve rregullatore të gjykatës, që detyrojnë dhënien e opinioneve prej ndihmësit për çdo çështje ku angazhohet, kjo veprimtari duket se mbetet e ndërvarur nga kërkesa e gjyqtarit pranë së cilit ndihmësi ushtron detyrën. Në këto kushte, dhe në mungesë të ndonjë kërkesë në formë të shkruar të drejtuar subjektit të rivlerësimit për dhënie opinionimi dhe mospërgjigjes nga ana e saj për këtë detyrë, për sa kohë sistemi dhe aktet në dosjen gjyqësore nuk japin të dhëna të tilla, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin për t'i dhënë një peshë specifike më të rëndë mangësive të saj profesionale, se sa ajo e përcaktuar prej Komisionit me vendimin e ndërmjetëm, që ka vendosur detyrimin e saj për t'iu nënshtuar trajnimit njëvjeçar në Shkollën

¹³ Shkresë nr. {***} prot., datë 12.11.2021.

¹⁴ Shkresë nr. {***} prot., datë 12.11.2021, e administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 13.11.2021.

¹⁵ Ligji nr. 49/2012, në nenin 6 "Ndihmësit ligjorë" (dispozitë e shfuqizuar nga neni 3 i ligjit nr. 39/2017) parashikonte: "1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ, në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor. 2. Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projekt-akte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material".

Neni 42 i ligjit nr. 98, datë 06.10.2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në republikën e Shqipërisë" (ndryshuar me ligjin nr. 46/2021, datë 23.3.2021).

e Magjistraturës.

20.5. Trupi gjykues, në lexim harmonik të parashikimeve të nenit E dhe nenit F të Aneksit të Kushtetutës, si edhe të kriterëve të vlerësimit profesional të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, të cilat zbatohen për atë që gjenden të përshtatshme për detyrat e këtij pozicioni pune, mban në konsideratë se vendimmarrja e Komisionit, lidhur me vlerësimin e kriterit profesional mund të cenohet vetëm si rrjedhojë e konstatimit se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime për të penguar apo vështirësuar vlerësimin e tij lidhur me këtë kriter apo ka model pune atë që do të ishte saqë ka rrezikuar të drejtat e qytetarëve. Për pasojë, në kushtet kur në drejtim të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit: (i) mangësitë e konstatuara mbeten në nivelin teorik; (ii) nuk rezultojnë që ato të kenë shkaktuar cenim të të drejtave të qytetarëve në mënyrë të drejtpërdrejtë për shkak të funksionit të saj jovendimmarrës; (iii) janë evidentuar në mënyrë të qartë dhe shteruese në vendimin e ndërmjetëm të Komisionit, si dhe janë reflektuar në vijim, sipas një vlerësimi me rezultatin “mirë” nga Shkolla e Magjistraturës, pranë të cilës mbi bazën e një kurikule të miratuar nga kjo e fundit, subjekti i rivlerësimit ka ndjekur programin e trajnimit njëvjeçar -- trupi gjykues vlerëson se qëndrimi i Komisionit se këto mangësi kanë qenë të shërueshme nëpërmjet trajnimit njëvjeçar është objektiv dhe proporcional.

21. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues pas vlerësimit me rezultatin “mirë” nga provimi përfundimtar i Shkollës së Magjistraturës, gjendet i drejtë dhe subjekti konsiderohet se arrin këtë nivel nën dritën e përcaktimit të nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me procedurën e punësimit

22. Lidhur me procedurën e punësimit të subjektit të rivlerësimit, e emëruar në detyrën e ndihmës ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit, në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të parashikuara nga ligji, si një fakt që tregon për shkelje të etikës nga ana e subjektit, trupi gjykues konstaton dhe analizon si vijon.

22.1. Nga aktet në dosjen gjyqësore, rezultojnë se nga hetimi mbi përvojën profesionale të subjektit të rivlerësimit, aftësitë profesionale dhe eksperiencën e saj¹⁶, duke vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk përmbushte kushtin e përvojës në punë për të aplikuar në pozicionin e ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit, sipas parashikimeve ligjore, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni ka vlerësuar ta pyesë subjektin pse ka aplikuar, kur dukej se ka qenë në kushtet e mospërmbushjes në mënyrë kumulative të kriterit ligjor. Shpjegimet e subjektit se periudha e angazhimit në dhënien e asistencës juridike vullnetarisht

¹⁶ Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për KLGj-në, në periudhën gusht 2010 - dhjetor 2011 figuron e punësuar juriste në shoqërinë “{***}” ShPK; në periudhën janar 2012 – mars 2016 ka deklaruar periudhë papunësie për arsye shëndetësore; nga data 14.04.2016 e vijim ushtron detyrën e ndihmës ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Sipas të dhënave nga hetimi administrativ ka rezultuar se znj. Jurida Bajraktari ka qenë e punësuar në institucione të ndryshme private dhe publike në Kosovë dhe Shqipëri në periudhat: (i) 05.09.2004 - 30.04.2005, shoqëria e sigurimeve “{***}” ShA., Prishtinë, Kosovë; (ii) 01.03.2006 - 31.03.2006 IEPV nr. {***}, Burgu {***}, Tiranë; (iii) 01.06.2006 - 30.06.2007 e punësuar te shoqëria e sigurimeve “{***}” ShA., Prishtinë, Kosovë; (iv) 01.07.2007 – 15.09.2009, sekretare në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor {***}; (v) 26.11.2009 - 20.4.2010 “{***}”; (vi) 01.08.2010 - 31.10.2010 e punësuar te shoqëria “{***}” ShPK, Tiranë; (vii) 01.11.2010 -30.11.2011 periudhë leje lindje, DRSSH Tiranë; (viii) 15.04.2016 e punësuar ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit.

pa pagesë pranë Shoqatës së Volejbollit për Femra në periudhën nëntor 2011- prill 2016 dhe pagimi i detyrimeve shoqërore e shëndetësore për 6 vjet, përkon me periudhën kohore prej 11 vitesh në ushtrimin e profesionit të juristit dhe është brenda kuadrit ligjor të përcaktuar në kriteret e vendosura nga neni 6/3 i ligjit nr. 49/2012, i kanë krijuar bindjen Komisionit se eksperiencia e punës së znj. Jurida Bajraktari nuk ka qenë në harmoni me kërkesat ligjore që kërkojnë përvojë profesionale si jurist në: organet e sistemit të drejtësisë; funksione publike në administratën e Kuvendit; administratën e institucionit të Presidentit; aparatit e Këshillit të Ministrave; ministri dhe institucione qendrore të pavarura; Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë; prokurorinë, si avokat apo si personel akademik i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Komisioni i ka çmuar edhe këto mangësi, pa dashur të ndërhyjë në gjykimin e komitetit *ad hoc*, si pjesë e mungesës së duhur të formimit profesional dhe aftësive të subjektit për të identifikuar konfliktin e normave apo aftësinë për të analizuar jurisprudencën dhe, më tej, aftësinë për të përgatitur opinione të karakterit procedural apo edhe material për çështjet në gjykim.

22.2. Në bisedimet përfundimtare në Kolegj, përfaqësuesja ligjore e subjektit të rivlerësimit, potencoi sa parashtuar në parashtime dhe gjatë gjyimit në Kolegj, duke u fokusuar te përvoja profesionale e subjektit në ushtrimin e funksioneve juridike dhe administrative në institucione dhe subjekte të ndryshme, në sektorin publik dhe atë privat, se subjekti ka përmbushur kriteret ligjore dhe etike për ushtrimin e detyrës, dhe se këto elemente të vlerësuara në tërësinë e tyre nuk përbëjnë në asnjë rast shkak për shkarkim në kuadër të procesit të vlerësimit kalimtar.

22.3. Trupi gjykues, *së pari*, çmon të sjellë në vëmendje se aspekti i etikës si një komponent i vlerësueshëm në kontekstin e procesit të rivlerësimit lidhet me sjellje të subjektit të rivlerësimit përgjatë periudhës së rivlerësimit, në përputhje me nenin 3, pika 12 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: “*Periudha e rivlerësimit*” është *periudha e punës së subjektit të rivlerësimit, gjatë të cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij, sipas këtij ligji*”. Kolegji e ka potencuar këtë qëndrim në jurisprudencën e tij në rastet kur ka trajtuar sjellje në këndvështrim të etikës së funksionarit të drejtësisë, të cilat i ka vlerësuar pa ndikim në këtë proces kur i kanë takuar një periudhe jashtë asaj të rivlerësimit¹⁷. Sjellja e subjektit të rivlerësimit e kërkuar për t’iu nënshtruar vlerësimit etik brenda këtij procesi, rezulton të ketë ndodhur para se ajo të merrte detyrën e ndihmësës ligjore, pra, jashtë *periudhës së punës*, në kuptim të dispozitës së sipërcituar, për pasojë ajo nuk mund të konsiderohet si një komponent i indikatorit të etikës sipas përcaktimeve të këtij ligji.

22.4. *Së dyti*, sipas një vlerësimi *obiter dictum*, trupi gjykues verifikoi edhe pretendimin e paraqitur rishtas prej Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në konkluzionet përfundimtare, se subjekti ka *fshetur fakte të vërteta* në kërkesën për aplikim të paraqitur prej saj në datën 01.04.2016, nga i cili rezultoi se ndonëse në kërkesë nuk ka një përshkrim të eksperiencës në punë të subjektit, atë e gjen të përshkruar plotësisht në dokumentin *Curriculum vitae* dhe në dokumentacionin shoqëruar së saj, të cilët janë vlerësuar nga organet përkatëse të përzgjedhjes dhe emërtesës. Në këtë kuptim, edhe në vlerësimin nga perspektiva e etikës morale të një qytetari, për sa kohë që në aplikimin e paraqitur nga subjekti nuk ka elementë të keqbesimit apo mashtrimit, kjo qasje në vetvete nuk do të ishte e mjaftueshme/vlefshme dhe as

¹⁷ Vendimi nr. 52/20204(JR) datë 24.10.2024 që i përket subjektit të rivlerësimit Lorenc Mërkuri; Vendimi nr. 12/2024 (JR) datë 02.04.2024 që i përket subjektit të rivlerësimit Artur Ismailukaj.

proporcionale për t'u ngritur në nivelin e një shkeljeje që ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

23. Në përfundim, duke marrë në analizë konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues konstaton se pretendimi i ankuesit se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe gjendet në kushtet e zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mbeti pa lëndë ku të mund të mbështetej e, për shkak të qëndrimeve të mësipërme lidhur me shkaqet e ankimit, u vlerësua i papranueshëm.
24. Për sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në konsideratë edhe të konkluzionit se subjekti ka rezultuar me nivel të besueshëm në drejtim të kriterit të kontrollit të figurës, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arriti në konkluzionin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 701, datë 25.09.2023, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, është i bazuar në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 701, datë 25.09.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 09.02.2026, në Tiranë.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Ne, gjyqtaret Ina Rama dhe Mimoza Tasi, kemi votuar për lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Jurida Bajraktari, me një arsyetim të ndryshëm nga ai i pasqyruar në vendim, vetëm sa i përket shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e aftësive profesionale.
2. Nga ankimi i Komisionerit Publik, lidhur me shkaqet që i adresohen kriterit të aftësive profesionale, konstatohet se ato ndonëse janë përdorur si shkaqe për të kundërshtuar vendimin e Komisionit, që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, në fakt kontestojnë drejtpërdrejtë vendimin e ndërmjetëm të marrë nga Komisioni me nr. 5, datë 20.07.2022, me anë të të cilit është vendosur pezullimi nga detyra e subjektit të rivlerësimit dhe detyrimi i saj për të ndjekur programin njëvjeçar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, vendim i cili, në zbatim të parashikimeve kushtetuese të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nuk është një vendim i ankimeshëm.
3. *Së pari*, konstatohet se ankimi lidhur me këtë kriter kundërshton konkluzionet e Komisionit të arritura për të njëjtat çështje/relacione të hartuara prej subjektit të rivlerësimit, të cilat janë marrë në analizë prej Komisionit në vendimin e tij të ndërmjetëm, të lartcituar, të marrë për shkak të mangësive të konstatuara në lidhje me kriterin e aftësive profesionale të saj. Ankimi fton trupin gjykues të bëjë një analizë dhe vlerësim të ndryshëm të mangësive të konstatuara në hartimin e këtyre dokumenteve ligjorë nga ai i bërë prej Komisionit, përpara se ndaj subjektit të vendosej masa disiplinore e pezullimit, vlerësim i cili, sipas arsytimit ndryshe të trupit gjykues, ka qenë i njëjtë në thelb me atë që ka bërë Komisioni në vendimin për konfirmimin e subjektit në detyrë.
4. Sipas vlerësimit tonë, dhe një qëndrimi të mbajtur në çështje të ngjashme të mëparshme¹⁸, në kushtet kur referuar akteve të administruara në dosje, rezulton se subjekti ka ndjekur programin e trajnimit, bazuar në kurikulat e Shkollës së Magjistraturës dhe nuk ka pasur ndonjë kontestim për mënyrën se si ajo është vlerësuar në përfundim të programit, për nivelin e tezës që i është dashur të zgjidhë në provimin përfundimtar ose për çdo lloj rrethane që do të kishte vënë në diskutim vijueshmërinë e ndjekjes së programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës apo rezultatin e provimit të përfundimit, në një prej formave që sugjeron zbatimin i nenit 60 të ligjit nr. 84/2016¹⁹, shërimi i problematikave nëpërmjet këtij programi prezumohet ligjërisht i realizuar dhe nuk mund të jetë objekt kontrolli i mëtejshëm prej Kolegjit.
5. Nëse në ankimin e Komisionerit Publik do të ishin evidentuar rrethana që lidheshin me zbatimin e kësaj dispozite, ne vlerësojmë se situata faktike nuk do të ishte e njëjtë me atë të vlerësuar prej Komisionit në marrjen e vendimit të ndërmjetëm dhe vendimi i konfirmimit do

¹⁸ Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 46, datë 10.06.2025, që i përket subjektit të rivlerësimit Marsida Frashëri, mendimi i pakicës.

¹⁹ Neni 60 i ligjit nr. 84/2016 parashikon se: "1. Pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit për një periudhë 1-vjeçare i jepet subjektit të rivlerësimit nëse janë evidentuar mangësi në aftësitë e tij profesionale që mund të plotësohen. 2. Në rast se subjekti i rivlerësimit përfundon programin e trajnimit, Shkolla e Magjistraturës i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë rezultatet e provimit përfundimtar, duke u shprehur nëse mangësitë janë mënjanuar ose jo. 3. Komisioni njofton subjektin e rivlerësimit brenda 10 ditëve të paraqesë një shpjegim me shkrim mbi arsyet e mospërfundimit me rezultate të kënaqshme të programit të trajnimit gjatë periudhës së pezullimit. Një kopje e këtij njoftimi i dërgohet vëzhguesit ndërkombëtar".

të duhej të kontrollohej për këto elementë të rinj të dalë rishtas, e të pavlerësuar me vendimin e konfirmimit në detyrë.

6. Përderisa nuk gjendemi para një situatë të tillë, pra, pa një lëndë të re e të patrajtuar në vendimin e ndërmjetëm për pezullim nga detyra, në vijim, qëndrimin tonë e mbështetëm në konstatimin se e gjithë analiza, në funksion të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit në drejtim të këtij kriteri, do të mbështetej mbi të njëjtat fakte, për të cilat është marrë vendimi i ndërmjetëm i Komisionit për pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe dërgimin në Shkollën e Magjistraturës.
7. Në këto kushte, kemi vlerësuar se ankimi i Komisionerit Publik, që *a prima facie* ankimon vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, konteston në fakt, për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vendimin e ndërmjetëm të Komisionit për pezullimin nga detyra dhe dërgimin e subjektit në Shkollën e Magjistraturës. Komisioneri Publik, duke mos qenë dakord me arsyetimin dhe vlerësimin e Komisionit se mangësitë mund të korrigjohen nëpërmjet trajnimit njëvjeçar, dhe në mungesë të së drejtës për të ankimuar drejtpërdrejtë vendimin e ndërmjetëm për shkak të ndalimit të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, ka përdorur të drejtën e tij për të kundërshtuar në tërësi vendimin e konfirmimit të subjektit, nëpërmjet kontestimit të tërthortë të vendimit të ndërmjetëm. Shkaqet e ankimit të ngritura në ankimin objekt gjykimi, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, i adresohen tërësisht problematikës së analizuar në kuadër të vendimit të ndërmjetëm për dërgimin në shkollën e Magjistraturës, të cilat, sipas ankimit, duhej të kishin çuar Komisionin, krahas problematikave të tjera lidhur me pasurinë dhe etikën, në marrjen e një vendimi shkarkimi dhe jo pezullimi.
8. Në ankimin objekt gjykimi, nuk rezulton të jetë prezantuar asnjë fakt që lidhet me hapat apo ngjarjet e ndodhura pas marrjes së vendimit për dërgimin në Shkollën e Magjistraturës, të cilat mund të kishin bërë të atakueshëm vendimin për konfirmim të subjektit, përtej çështjeve të analizuar në vendimin e ndërmjetëm, siç mund të ishin kurikulat e papërshtatshme, problematika me nivelin e kalimit të provimit përfundimtar të kryer në kuadër të programit të trajnimit, sipas nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, apo gjetje e kontestime të bëra prezent prej vëzhguesve ndërkombëtarë, që lidhen me trajnimin apo provimin përfundimtar dhe vlerësimin e arritur në fund të tij. Të tilla kontestime mund të adresoheshin ndaj vendimit të Komisionit për konfirmimin edhe nëse rezultati i provimit nuk do të ishte vlerësuar si i kënaqshëm prej Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës.
9. Në këto kushte, kemi vlerësuar se, në vijim të konkluzioneve për çështjet e këtij kriteri, në këndvështrim të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, ndaj këtij vendimi të Komisionit, nuk mund të ushtrohet kontroll nëpërmjet ankimit, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për arsyet e renditura si më poshtë.

9.1. Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: “*Ndaj vendimeve të Komisionit mund të ushtrojnë ankim pranë këtij Kolegji subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, sipas ligjit, me përjashtim të vendimeve të marra, sipas nenit E, paragrafi 2 të Aneksit*”.

9.2. Ndërsa neni E, paragrafi 2 i Aneksit të Kushtetutës, parashikon se: “*Vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra, shoqëruar me detyrimin për trajnim identifikon mangësitë. Gjatë periudhës së pezullimit, të rivlerësuarit i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj. Subjekti i rivlerësuar urdhërohet të ndjekë një program edukimi njëvjeçar pranë Shkollës së*

Magjistraturës, i hartuar për të plotësuar mangësitë. Në fund të programit ai testohet për aftësitë e tij. Ky testim mbikëqyret nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. Subjekti i rivlerësimit që nuk e kalon testimin shkarkohet nga Komisioni”.

9.3. Në një lexim harmonik të këtyre parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës, arrihet në konkluzionin se vendimi i Komisionit për pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe urdhërimin për ndjekje të programit njëvjeçar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës është një vendim ndaj të cilit nuk lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit e për të cilin Kolegji nuk gëzon juridiksion *ratione materiae*.

9.4. Neni E, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, parashikon se Komisioni merr një vendim të tillë: *“Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, atëherë kjo konsiderohet mangësi profesionale dhe zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit, shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.* Kjo dispozitë kushtetuese është transpozuar edhe në nenin 44, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: *“Në përfundim, relatori propozon për subjektin e rivlerësimit si më poshtë: b) “Me mangësi”, kur subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv. Komisioni ka rekomanduar program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës për të plotësuar këto mangësi brenda një viti”.*

9.5. Sipas një interpretimi sistematik dhe teleologjik të këtyre dispozitave, në vlerësimin tonë, rezulton se ligjvënësi ka njohur diskrecionin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit deri në konstatimin e mangësive dhe mundësisë për shërim nga trajnimi njëvjeçar. Ky vlerësim duket se vjen në mënyrë parësore prej Komisionit dhe konfirmohet *ipso lege* si i tillë, duke ia lënë peshën e kësaj vendimmarrjeje në mënyrë të plotë dhe përfundimtare këtij organi, që kryen edhe vlerësimin profesional, në zbatim të dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

9.6. Përjashtimi që bën neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës për të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi lexohet si qëllim i ligjvënësit për të moslejuar kontrollin mbi të, në mënyrë përjashtimore dhe të shprehur. Ky përcaktim kushtetues nuk lejon as ankimin e tij me vendimin përfundimtar, siç është ai i konfirmimit, pasi, parashikimi kushtetues nuk ndalon vetëm ankimin e veçantë ndaj këtij vendimi, por nuk lejon ankim ndaj tij në asnjë stad/fazë të procesit të rivlerësimit, duke i dhënë atij formë të prerë me ligj, dhe madje duke sugjeruar edhe ekzekutimin e tij të menjëhershëm.

9.7. Në këtë kuptim, çështjet e analizuara në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, e për të cilat Komisioni, si organi kompetent, ka urdhëruar pezullimin dhe dërgimin në Shkollën e Magjistraturës, nuk mund t’i nënshtrohen kontrollit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për shkak të ankimit të një prej palëve, por as të vlerësohen prej tij në mënyrë incidentale, për sa kohë që Kolegji shqyrton çështjet si një gjykatë apeli, brenda kufijve të shkaqeve të ankimit, parim i cili është konservuar e zbatuar me rigorozitet nga jurisprudenca e Kolegjit në vite.

9.8. Duke e konsideruar këtë vendim si një vendim të formës së prerë, edhe në këndvështrim të përcaktimeve procedurale të përgjithshme të parashikuara nga neni 451, shkronja “a” e Kodit

të Procedurës Civile²⁰, arsyet apo konkluzionet e arritura në të nuk mund të jenë më objekt i kontrollit gjyqësor as nga një gjykatë më e lartë, siç është Kolegji, sepse përndryshe do të gjendeshim para cenimit të parimit *ne bis in idem*, qoftë ky kontroll edhe në funksion të shqyrtimit të një ankimi të tërthortë apo të maskuar ndaj tij.

10. Për sa më lart, në vlerësimin tonë, problematikat e ngritura në ankim, që i adresoheshin kriterit të aftësive profesionale, nuk mund të ishin objekt shqyrtimi në Kolegj e, për këtë pjesë të ankimit, konfirmohen *ipso lege* konkluzionet e Komisionit në vendimin e konfirmimit.
11. Në këto kushte, të vetmet problematika që mbeteshin për t'u vlerësuar prej trupit gjykues, në vlerësimin tonë, ishin ato që lidheshin me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe çështje të etikës, të ngritura në kontekstin e procedurave të emërimit të subjektit, për të cilat ndajmë të njëjtin qëndrim, me të njëjtin arsyetim si pjesa tjetër e trupit gjykues, ashtu si edhe për vetë zgjidhjen e çështjes në tërësi.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

²⁰ Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur: (a) nuk mund të bëhet ankim kundër tij.